REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA FIER**
**KOMISIONI I STREHIMIT**

**Nr. 1090.. Prot.** **Fier më 24../01./2025**

**PROJEKT- VENDIM**

**Nr. 07, datë 24 / 01 /2025**

**"PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA, QË BANOJNË ME QIRA NË TREGUN E LIRË DHE NUK KANË TË ARDHURA TË MJAFTUESHME PËR TA PËRBALLUAR VETË GJITHË VLERËN E QIRASË"**

Komisioni i strehimit, pasi shqyrtoi dokumentacionin administrativo-ligjor përkatës, në mbështetje të Ligjit nr.22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar, neni 2, pikat 1, 4, 20, 25, 26, 27, 29, 30, 33, 34, neni 37, 42, neni 4, neni 20, nenet 33, 34, 36, 38 dhe 39, VKM nr.384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe proçedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore", VKM Nr.459 datë 3.7.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin", VKM nr.301, datë 15.04.2021, "Për normat e strehimit", VKM nr. 362, datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij", VKB nr. 129, datë 20/11/2024 , nr.12238/2 prot , date 05/12/2024 "Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë dhe miratimin e e vlerës mesatare të qirasë në tregun e lirë, për efekt të llogaritjes së masës së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij për vitin 2025, VKB nr. 128, datë 26.11.2024 , nr.12237/2 prot , date 05/12/2024 "Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin social të strehimit "Subvencionimi i qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij" për vitin 2025, të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore",i ndryshuar, neni 24, gërma k, komisioni i strehimit :

**Propozon :**

**1.** Te miratoje masen e subvencionit të qirasë për familjet e pastreha, që banojnë me qira në tregun e lirë dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për ta përballuar vetë gjithë vlerën e qirasë (tabela bashkëlidhur);

**2.**Subvencioni i qirasë sipas pikës 1 do t'i jepet familjeve perfituese nga momenti i miratimit me Vendim të Këshillit Bashkiak.

**3**.Efektet financiare sipas pikës 1, do të mbulohen në masën 80% nga buxheti i shtetit dhe 20% nga Buxheti i Bashkisë Fier për vitin 2024.

**4**.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Fier.

**Komisioni i Strehimit**

**1.**Pranvera Çina

**2.**Melsi Bogdani

**3.**Merita Bitri

**4**.Elvi Daka

**5.**Themion Mile

**6**.Endri Jaupaj

**7.**Kreshnik Dapi

**8**.Rrapi Gjika

**9.**Denisa Azizaj

Konceptoi: D.Azizaj

E.Kapllanaj

**KRYETAR**
**Armando Subashi**

**NË MUNGESË ME AUTORIZIM**
**Sekretari i Përgjithshëm**
**Martin Dodi**